



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji,
Kulturë, Rini e Sport
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 3.07.2008 ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës
Salla nr. N.225

P R O C E S V E R B A L

nga mbledhja e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport

Në mbledhje morën pjesë: Agim Veliu, Drita Kadriu, Enis Kervan, Vlora Çitaku, Fatmire Berisha, , Heset Cakolli.
Munguan: Adem Hajdaraj, Memli Krasniqi, Donika Kadaj-Bujupi , Mark Krasniqi. dhe Dragan Dimiq

Nga sekretaria e Kuvendit morën pjesë: Bajram Badivuku, dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e udhëhoqi Agim Veliu- kryetari i Komisionit.
Për këtë mbledhje është paraparë ky:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare.
4. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua nga anëtarët e Komisionit.

1. Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Agim Veliu fjalën ia dha raportueses së Projektligjit.

Drita Kadriu, tha se me mbështetje të anëtarëve të komisionit e kemi amendamentuar nen për nen Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

Stafi i administratës me saktësi e ka hartuar rekomandimin për Projektligjin.

Ajo propozoi që në titull pas fjalës ‘kombëtarë’ të shtohet fjala ‘Shtetërorë’.

Titulli i Projektligjit duhet të riformulohet:

Projektligji për Ansamblin Kombëtar- Shtetëror të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera”.

Të gjithë anëtarët e komisionit u pajtuan me riformulimin e titullit e cila duhet të inkorporohet në tërë tekstin e Projektligjit.

Propozoi që në nenin 16 pika a) Harton ‘politikat’ të zëvendësohet me fjalën ‘programet’. Njëkohësisht paqartësi paraqiti në nenin 27, rreth çështjes së anëtarëve, pra për numrin e punëtorëve.

Pas diskutimeve nga anëtarët e komisioni rreth nenit 16 dhe nenit 27, ata nuk u pajtua me këto propozime.

Komisioni e konsiderojë të miratuar rekomandimin e Projektligjit për Ansamblin Kombëtar të Këngëve dhe Valleve “Shota” dhe për Ansamblet e tjera.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare

Agim Veliu për pikën e tretë fjalën ia dha raportueses.

Vlora Çitaku- Ajo konsideron se ky Projektligj është një ndër ligjet më të mira që ka ofruar Ministria e Arsimit Kuvendit të Kosovës, si për nga struktura, qartësia, gjuha etj. Si referuese e Projektligjit prezantoi para anëtarëve të tjerë të Komisionit propozim amendamentet e Projektligjit për Kualifikimet Kombëtare.

Anëtarët e Komisionit filluan me leximin nen për nene të Projektligjit dhe propozuan këto amendamente:

Amendamenti 1

Preambula dhe neni 25 të përshtatet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Amendamenti 2

Neni 1, paragrafi 2, pika f) fjala “progres” zëvendësohet me “përmirësim”.

Amendamenti 3

Neni 2, tek përkufizimi “**Akreditimi**” në reshtin e 3 fjala “njeh” zëvendësohet me “**përcakton**”.

Tek përkufizimi “**Aprovimi**” në reshtin e fundit “të jetë lëndë” zëvendësohet me “**ti nënshtrohet**”.

Tek përkufizimi “**Arsimi Informal**” fjalia e fundit “Ky lloj arsimi nuk ka strukturë dhe zakonisht është i rastësishëm dhe i paparamenduar.”, fshihet.

Tek përkufizimi “**Certifikata**” në reshtin e dytë fjala “suksesshëm të” si dhe tek përkufizimi “**Diploma**” fjala “të suksesshëm”, fshihen.

Tek përkufizimi “**Kredit**” në fillim shtohet “është” dhe vazhdon me “një....”, ndërkaq në reshtin e dytë para lidhëses “që” shtohet “dhe”.

Tek përkufizimi “**Kompetenca**” në reshtin e 4 pas fjalës “praktike” vehet pikë dhe teksti në vijim “dhe shprehitë siç është marrja e përgjegjësive dhe puna e pavarur.”, fshihet.

Tek përkufizimi “**Njohja e mësimit paraprak**” në reshtin e 6, pas fjalës “informal” vehet pikë, ndërkaq teksti në vijim riformulohet “**Kjo njohuri praktike do të shfrytëzohej për ti dhënë mundësi individit që të avancohet ose të lirohet për një pjesë të kursit ose kredisë drejt kualifikimit**”.

Tek përkufizimi “**Përshkruesit e nivelit**” në reshtin e parë “i shkurtër”, hiqet.

Tek përkufizimi “**Vlerësimi**” në fund fjalët në kllapa , fshihet.

Amendamenti 4

Neni 3, fshihet.

Amendamenti 5

Neni 6, paragrafi 6 , fshihet.

Amendamenti 6

Neni 7, paragrafi 2, riformulohet : “**2. Kërkesat janë në pajtim me nivelet e KEK**”.

Amendamenti 7

Neni 9

Paragrafi 2, fshihet.

Paragrafi 4, fjalia “prej numrit të anëtarëve të vet.” zëvendësohet me “**nga radhët e veta**”.

Paragrafi 6, riformulohet :

“**6. Me qëllim të përpilimit të listës fillestare të personave të emëruar, MASHT themelon një komision të veçantë, Komisioni miraton metodën pasuese të përzgjedhjes së anëtarëve dhe rregullave për periudhën e shërbimit, pjesëmarrjes dhe shkarkimit, që do të caktohen me një akt nënligjor të punës të hartuar nga AKK**”.

Amendamenti 8

Neni 10, paragrafi 1, riformulohet : “**1. Këshilli drejtues i AKK takohet së paku gjashtë (6) herë në vit.**”

Amendamenti 9

Neni 17, fjalia e fundit “**Këto do të jenë zakonisht institucionet, që ofrojnë arsim dhe aftësim, mirëpo kjo nuk është kërkesë.**”, fshihet.

Amendamenti 10

Neni 20, në reshtin e parë fjala “të rënda” , fshihet.

3. Të ndryshme

Vlora Çitaku – theksoi se organizimi i mbajtjes së provimit të maturës ka qenë në nivel nga ana e Ministrisë, mirëpo paraqiti pakënaqësi rreth nivelit të suksesit dhe rezultatit të ulët të provimit të maturës i cili është 47 %. Duhet të marrim vendim strategjik se vitin e ardhshëm pragu i kalueshmërisë së provimit do të jetë 70%, pra pas tre vitesh vlerësimi do të jetë 100%.

Agim Veliu tha se provimi i maturës është organizuar sipas Ligjit, mirëpo pas shpalljes së rezultateve është marrë vendim për uljen e pragut të kalueshmërisë nga 50% në 45%.

Komisioni shqyrtoi çështjen rreth autoritetit të komisioneve për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve dhe vlerësoi se ky provim është mbajtur komforë dispozitave të Ligjit për provimin e Maturës, mirëpo për arsye të ndërrimit të kriterëve nxori këtë :

K O N K L U D I M

Komisioni shprehë papajtueshmërinë e tij me vendimin e Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbritjen e pragut të kalueshmërisë nga 50% në 45%, dhe i

R E K O M A N D O N

Ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të zbatoj Ligjin dhe raste të tilla mos të përsëriten.

Kompromiset me ligjet e miratuara në Kuvendin e Republikës së Kosovës janë të papranueshme.

Gjithashtu komisioni diskutoi rreth kushteve të punës në komision dhe vlerësoi se ato janë përmirësuar në krahasim me dy mandatet e kaluara, mirëpo pajisjet lehtësojnë punën me rastin e shqyrtimit të projektligjeve, dhe u pajtua lidhur me këtë:

Kërkesë

Komisioni kërkon nga Kryesia e Kuvendit të sigurohen pajisjet siç janë, një projektorë dhe shtëpiza me tastaturë, meqë këto pajisje mundësojnë shqyrtimin më preciz të projekteve.

Mbledhja përfundoi në ora 13:30.

Kryetari i Komisionit,
Agim Veliu